

Në bazë nenit 27 paragrafi (2) pika 8 të Ligjit për arsimin e lartë (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 82/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr.178/21 dhe 58/24), nenit 28, 29 dhe 30 të Statutit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Rregullores për sistemin e vetëm të transfereve të kredive dhe kalim nga njëri program studimor në tjetrin, përkatësisht nga njëra Njësi e Universitetit në tjetrën nr. 0201-1231/3 të datës 30.09.2019, Vendimit të Drejtorisë Rektoriale nr. 02-60/1 të datës 21.01.2025, Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup:

## **K O N K U R S**

**për transferim të studentëve në ciklin e parë të studimeve në fakultetet dhe njësitë akademike të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup për vitin akademik 2024/2025**

### **1. Transferimi i studentëve në ciklin e parë të studimeve realizohet në të gjithë fakultetet/programet studimore të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, edhe atë:**

#### **1.1 Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës;**

- Arkitekturë dhe dizajn
- Ndërtimtari – konstruktive

#### **1.2 Fakulteti i Shkencave Informatike;**

- Informatika
- Informatika – mësimore
- Shkenca kompjuterike dhe inxhinierike
- Programim i aplikuar

#### **1.3 Fakulteti i Shkencave Teknike;**

- Dizajni i qëndrueshëm në inxhinierinë makinerike
- Mekatronikë
- Inxhinieri e transportit dhe komunikacionit
- Menaxhment industrial
- Elektroenergetika dhe burimet e ripërtrishme të energjisë
- Inxhinieria e mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes së ambientit

#### **1.4 Fakulteti i Shkencave Teknologjike;**

- Teknologji ushqimore
- Dizajn i prodhimeve kimike dhe proceset
- Inxhinieria Biokimike
- Tekstil dizajn dhe modelimi

#### **1.5 Fakulteti i Shkencave Sociale;**

- Studimet politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare
- Politikë sociale dhe punë sociale
- Media dhe komunikim ndërkulturor
- Sport dhe shkenca sportive
- Administrim publik dhe menaxhim me burimet njerëzore
- Ekonomi e zbatuar dhe ndërmarrësi
- Psikologji

#### **1.6. Fakulteti Juridik**

- Studimet e Drejtsise
- Kriminalistik

#### **1.7. Fakulteti Ekonomik**

- Marketing dhe Menaxhment
- Finansa dhe Kontabilitet
- Dogana, shpedicion dhe sigurime

#### **1.8. Fakulteti i shkencave humane**

- Gjuhe dhe Letersi Angleze
- Gjuhe dhe Letersi Gjermane
- Perkthim Shqip-Maqedonisht-Gjermanisht dhe anasjeltas

## **2. Kushtet e transferimit të studentëve në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup:**

### **A. Studentë me status të studentit të Universitetit „Nënë Tereza“ në Shkup:**

A.1. Të drejtë transferimi brenda njësisive akademike të UNT-së kanë të gjithë studentët të cilët kanë indeks të UNT-së sipas kushteve dhe kritereve aktuale të caktuara me Rregullore për studime;

A.2. Transferimi i studimeve realizohet vetëm në programet studimore aktive të fakulteteve amë;

A.3. Pas realizimit të transferimit të ECTS kredive, studentit gjatë regjistrimit në programin e transferuar është i obliguar të çregjistroj studimet nga programi i cili transferohet, varësisht natyrës së programit studimor dhe mënyrës së studimeve;

## **B. Studentë nga institucionet tjera të arsimit sipëror:**

**B.1.** Të drejtë transferimi nga institucionet tjera të arsimit sipëror në njësitë akademike të UNT-së kanë të gjithë studentët që kanë regjistruar dhe të përfunduar së paku një vit akademik nga Universiteti (ose kanë diplomuar) i cili vjen kandidati dhe kanë të akumuluar ECTS kredi të cilat do të mund të transferohen në programin e caktuar studimor ku aplikon studentin.

**B.2.** Gjatë aplikimit, kandidati detyrimisht duhet të paraqesë dëshmi për akreditimin e institucionit të arsimit të lartë, respektivisht fakultetit apo programit nga i cili transferohet;

**B.3.** Studenti mund të transferohet në fakultetin dhe programin e njëjtë studimor ose në drejtime të ngjashme në fakultetet dhe programet studimore të UNT-së. Ngjashmërinë e programeve studimore e përcakton komisioni i fakultetit për transfer.

### **3. Afatet e paraqitjes për transferimin dhe regjistrim në UNT:**

- Kandidatët të cilët transferohen në UNT regjistrohen me vetëfinancim në studime, respektivisht sipas tarifave aktuale të studimit për programet studimore në vitin akademik 2024/2025.

• **Paraqitja e kandidatëve (aplikimi): 20.01 – 31.01.2025**

• **Sjellja e vendimeve përfundimtare: 03.-04.02.2025**

• **Regjistrimi i kandidatëve: 04.-07.02.2025**

### **4. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

- Fletëparaqitja për aplikim
- Çertifikata origjinale e notave dhe indeksi nga universiteti amë;
- Dëshmi për akreditimin e njësisë akademike (shtetasit e huaj). Gjatë aplikimit, kandidati detyrimisht duhet të paraqesë dëshmi për akreditimin e institucionit të arsimit të lartë, respektivisht fakultetit apo programit nga i cili transferohet;
- Dëftesat origjinale të shkollimit të mesëm dhe Diplomën e shkollës së mesme të kryer;
- Dëshmi për nostrifikimin e shkollimit të mesëm nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RM-së (për shtetasit e huaj);
- Çertifikatën e lindjes dhe dëshmi për nënshtetësi (çertifikatë ose aktvendim);
- Vërtetim për pagesën e transferit: 850 denarë në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të taksave administrative.

Kandidatët të cilët janë të pranuar (pas shpalljes/dhënies së Vendimit përfundimtar), në afatin e caktuar duhet të realizojnë regjistrimin e studimeve, në të kundërtën vendimi i transferimit do të shpallet i pavlefshëm.

### **5. Gjatë regjistrimit kandidatët duhet të dorëzojnë:**

1. Fletëparaqitje për regjistrim
2. Fletëçregjistrimin e studimeve nga fakulteti i cili transferohet
3. Fotografi (dy fotografi 6 x 9 dhe dy fotografi 4 x 5 cm)
4. Vërtetim për pagesën e mjeteve dhe atë:
  - 800 denarë në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Indeksit;
  - 750 denarë në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të veprimtarive informative, sportive, kulturore të studentëve të Universitetit;
  - 3000 denarë në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të shpenzimeve për realizimin e transferimit;
  - Pagesën për semestër.

Të gjitha pagesat e lartpërmendura duhet të kryhen në xhiro-llogarinë e Universitetit në këtë mënyrë:

- Në “emër të marrësit” (“назив на примачот”) – Universiteti “Nënë Tereza” – Shkup
- Në “banka e marrësit” (“банка на примач”) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë,
- Në “llogaria” (“сметка”) 10000000063095,

- Në “Ilogaria e shfrytëzuesit buxhetor- subjekti shfrytëzues” (сметка на буџетски корисник единка корисник) - 1600162677 788 15
- në “shifra dhe programi i të hyrave” (“Приходна шифра”) 723012,
- Në “thirrja në numrin” (“програма”) 45.

Të gjithë kandidatët dokumentet e tyre për aplikim duhet t'i dorëzojnë në hapsirat e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup në rrugën “rr. “1669” nr. 11A / 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Konkursi do të shpallet në faqen e internetit: <http://www.unt.edu.mk>